

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.

**Pasqyrat Financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(së bashku me raportin e audituesit të pavarur)

PËRMBAJTJE

Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Politikat domethënëse kontabël	5
3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	12
4. Publikime të reja të kontabilitetit	12
5. Administrimi i rrezikut të sigurimit	13
6. Administrimi i rrezikut financiar	16
7. Vlera e drejtë	21
8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	22
9. Depozita me afat me bankat	22
10. Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	23
11. Investime në filiale me kosto	23
12. Investime në fonde investimi (kuota) me vlerë të drejtë	24
13. Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	24
14. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	24
15. Prona dhe pajisje dhe aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë	25
16. Aktive afatgjata jo-materiale	26
17. Rezervat teknike dhe matematike, rezervat për primin e pafituar, aktive të risigurimit	26
18. Llogari të pagueshme për risigurimin	27
19. Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe detyrime të tjera	27
20. Kapitali aksionar	28
21. Primet e shkruara bruto	28
22. Të ardhurat nga interesi	28
23. Shpenzimet e marrjes në sigurim	28
24. Shpenzime administrative	28
25. Shpenzime të tjera operative	29
26. Tatimi mbi fitimin	29
27. Detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet	30
28. Transaksionet me palët e lidhura	31
Skedule suplementare (të pa-audituar)	a

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale të Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. ("Shoqëria") janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare individuale të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024;
- pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën individuale të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale, të cilat përfshijnë politika domethënëse kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare individuale të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK") dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë që janë të zbatueshme për auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin Vjetor, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare individuale dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare individuale nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identikuara më sipër kur të na vendosen në dispozicion dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare individuale apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Kur ne të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se në të gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këtë çështje drejtimit.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare individuale

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale sipas kërkesave të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtuesit synojnë që Shoqëria të likuidohet apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare individuale

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare individuale në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare individuale, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose shmangie të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.



Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor

Jonid Kamllari

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Jonid Kamllari", written over the printed name.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

30 prill 2025

Tiranë, Shqipëri

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e pozicionit financiar – 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8	47,845	48,027
Depozita me afat me bankat	9	1,145,488	1,086,386
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	10	1,324,625	1,342,740
Investime në filiale me kosto	11	11,232	11,232
Investime në fonde investimi (kuota) me vlerë të drejtë	12	10,657	10,027
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	13	48,938	45,525
Tatim i parapaguar mbi të ardhurat		3,683	-
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	14	19,661	35,522
Aktive të risigurimit	17	12,737	6,579
Aktiv tatimor i shtyrë	26	-	2,697
Prona, paisje dhe aktive me të drejta përdorimi	15	35,823	25,523
Aktive afatgjata jo-materiale		6,860	8,096
Aktive të tjera	16	2,596	2,824
TOTALI I AKTIVEVE		2,670,145	2,625,178
DETYRIME			
Rezerva teknike dhe matematike	17	1,765,159	1,758,872
Llogari të pagueshme për risigurimin	18	1,189	4,270
Tatim fitimi për t'u paguar	26	-	16,446
Detyrim tatimor i shtyrë		7,095	-
Detyrime të qirasë	15	26,499	14,889
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe detyrime të tjera	19	46,781	22,337
TOTALI I DETYRIMEVE		1,846,723	1,816,814
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	370,000	370,000
Rezerva e rrezikut të sigurimit	20	272,811	272,811
Fitime të pashpërndara		140,404	180,834
Rezervë rivlerësimi e investimeve të disponueshme për shitje		40,207	(15,281)
TOTALI I KAPITALIT		823,422	808,364
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,670,145	2,625,178

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë më 17 prill 2025 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

Edvin Hoxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

Edmira Madani
Drejtoresh e Financave

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	21	820,723	826,097
Prime të shkruara ceduar risiguruesit		(16,880)	(16,976)
Prime të shkruara neto		803,843	809,121
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit		(4)	372
Të ardhura neto nga sigurimi		803,839	809,493
Të ardhura nga interesi	22	96,102	85,973
Të ardhura të tjera		7,167	10,495
Të ardhura totale, neto		907,108	905,961
Ndryshimi në rezervat matematikore	17	3,407	29,500
Rregullimi i provizioneve për dëme të raportuara dhe të pa-raportuara	17	(187,963)	(160,623)
Dëme të paguara nga risiguruesi		8,760	-
Shpenzimet neto të sigurimeve		(175,796)	(131,123)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	23	(336,562)	(309,096)
Shpenzime administrative	24	(119,215)	(156,246)
Shpenzime të tjera operative	25	(75,788)	(18,848)
Fitimi operativ		199,747	290,648
Humbja nga kursi i këmbimit, neto		(39,561)	(82,726)
Fitimi para tatimit		160,186	207,922
Tatim fitimi	26	(25,737)	(33,042)
Fitimi i vitit		134,449	174,880
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që kalojnë më pas në fitim humbje</i>			
Rivlerësimi i investimeve në letra me vlerë (të disponueshme për shitje)	10	65,281	116,863
Tatimi i shtyrë	26	(9,792)	(17,529)
		55,489	99,334
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		189,938	274,214

Shënimet në faqet 5 deri në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurisë	Rezervë rivlerësimi e investimeve të disponueshme për shitje	Fitime të pashpërndara	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	370,000	272,811	(114,616)	91,682	619,877
Fitimi i vitit	-	-	-	174,880	174,880
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse pas tatimit	-	-	99,334	-	99,334
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	99,334	174,880	274,214
Dividend i paguar	-	-	-	(85,727)	(85,727)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	370,000	272,811	(15,282)	180,835	808,364
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	134,449	134,449
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse pas tatimit	-	-	55,489	-	55,489
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	55,489	134,449	189,938
Dividend i paguar	-	-	-	(174,880)	(174,880)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	370,000	272,811	40,207	140,404	823,422

Shënimet në faqet 5 deri në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

	Shënime	2024	2023
Flukset monetare nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Fitimi i vitit		134,449	174,880
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	15, 16	8,909	9,768
Të ardhurat nga interesi		(96,102)	(85,973)
Pakësimi i AAGJ-ve	25	-	59
Ndryshimi në fonde investimi me vlerë të drejtë		630	-
Shpenzime për tatimin mbi fitimin		25,737	33,043
Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		73,623	131,777
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Pakësim në kosto të shtyra të marrjes në sigurim		15,861	2,753
Rritje në llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera		(3,413)	(4,286)
Rritje në aktive të risigurimit		(6,158)	(371)
Rritje në aktive të tjera		228	(2,126)
(Rënie)/rritje në rezerva teknike dhe matematike		6,288	(13,656)
Rritje/(pakësim) në llogari të pagueshme për risigurime		(3,081)	882
Pakësim në llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera		24,444	(6,036)
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative		34,168	(22,840)
Tatim fitimi i paguar	26	(45,866)	(17,776)
Flukset monetare të përdorura nga veprimtaria shfrytëzuese		61,925	91,161
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë investuese			
Shtesa në aktive afatgjata jo-materiale	16	(683)	(1,907)
Shtesa në aktive afatgjata materiale	15	(725)	(258)
(Shtesa)/maturimi i depozitave me afat		(59,940)	92,475
Shtesa në investime në letra me vlerë		85,265	(170,602)
Arkëtime nga maturimi i investimeve në letra me vlerë		-	-
Interesa të marra		96,713	73,549
Flukset monetare të përdorura nga veprimtaria investuese		120,630	(6,743)
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë financuese			
Dividendi i paguar	20	(174,879)	(85,727)
Pagesat e qirasë		(7,858)	(5,898)
Flukset monetare nga veprimtaria financuese		(182,737)	(91,625)
Rritja/(ulja) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(182)	(7,207)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		48,027	55,234
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	8	47,845	48,027

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" të Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. ("Shoqëria") për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.

Shoqëria u themelua në shtator 2004 si një shoqëri sigurimi me kapital aksionar dhe u regjistrua në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 32018, datë 3 shtator 2004.

Shoqëria po vepron aktualisht sipas ligjit shqiptar Nr. 52/2014 "Për sigurime dhe risigurime", datë 4 korrik 2014. Aktivitetet kryesore të saj përfshijnë shërbimet e sigurimit të jetës.

Shoqëria ka filluar aktivitetin e saj të biznesit në muajin mars 2005 dhe zyrat kryesore janë të vendosura në **Tiranë, Qendra e Biznesit Sigal, Bulevardi "Zogu I"**.

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Shoqëria zotërohet nga Sigal Uniqa Group Austr SH.A. ("Shoqëria mëmë"), një subjekt rezident në Shqipëri. Shoqëria kontrolluese përfundimtare është UNIQA Versicherungsverein Privatstiftung, Vjenë, Austri.

Shoqëria zotëron një filial në Shqipëri që administron një fond pensioni vullnetar me kontribut të përcaktuar që nuk është konsoliduar në këto pasqyra financiare (Shënimi 11).

Drejtimi i Shoqërisë

Administratori i Shoqërisë është z. Edvin Hoxhaj. Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2024 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, përbehet nga:

Andreas Brandstetter	Kyetar/Anëtar
Wolfgang Kindl	Anëtar
Mag Gerald Muller	Anëtar
Georgios Bartzis	Anëtar
Vinzenz Benedict	Anëtar

Më 31 dhjetor 2024, Shoqëria kishte 16 të punësuar (2023: 19)

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lekë ("Lekë") dhe rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Monedha funksionale e shoqërisë është monedha në mjedisin primar ekonomik në të cilin ajo operon.

2. Politikat domethënëse kontabël

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 52/2024 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" në bazë të kostos historike të modifikuar nga vlerësimi me vlerë të drejtë i investimeve në letra me vlerë të disponueshme për shitje dhe i investimeve në fonde investimesh me vlerë të drejtë në fitim/humbje. Politika domethënëse të kontabilitet të përdorura në këto pasqyra financiare paraqiten në vijim. Ato janë zbatuar në mënyrë të rëndësishme për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur në këto pasqyra tregohet ndryshe.

Në këto pasqyra financiare individuale, Shoqëria ka njohur si investim me koston historike dhe nuk ka konsoliduar shoqërinë e kontrolluar prej saj, Shoqërinë Administruese të Fondeve Sigal Life Uniqa Group Austria Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve Kolektive SH.A. ("filiali") (Shënimi 11). Shoqëria kontrolluese e Grupit UNIQA Österreich Versicherungen, Austri si dhe Shoqëria mëmë Sigal Uniqa Group Austria SH.A. përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara në të cilat Shoqëria dhe Filiali konsolidohen. Pasqyrat financiare të konsoliduara të përgatitura nga Shoqëria mëmë mund janë të publikuara në faqen e saj të internetit <http://www.sigal.com.al/>. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 me qëllim të marrjes së informacionit të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet e operacioneve dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit si një i tërë.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në vend në datën e raportimit.

2. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetare që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë konvertuar në kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose indirekt, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale kontabilizohen me kosto historike. Më shumë detaje mbi investimet në filiale janë dhënë në Shënimin 11.

Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat në të cilat Shoqëria pranon rrezik të rëndësishëm siguri klasifikohen si kontrata siguri. Rreziku i sigurimit është rrezik tjetër përveç rrezikut financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë ndryshoreve midis një norme interesi specifike, çmimi i sigurimit, çmimi i mallrave, kursit të këmbimit, indeksi i çmimeve ose normave, një vlerësim kredie ose indeks kredie ose ndryshore tjetër, e një ndryshoreje jo-financiare që ndryshuesi nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe disa rreziqe financiare.

Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i) *Primet për sigurimin e jetës*

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht me një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet paraqiten bruto para detyrimeve të komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatime dhe detyrime tatimore apo doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve për të cilat shuma e detyruar vlerësohet të jetë e pa-arkëtueshme, çregjistrohen. Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë të risigurimit.

ii) *Rezerva për primet e pafituara*

Rezerva për "Jetën e Debitorit" dhe sigurimin e "Jetës së Kombinuar" është përlogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pa-maturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficientin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës si dhe ndërkohë UPR-ja për rrezikun e humbjes së jetës nga aksidentet dhe të shëndetit. Shoqëria ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafitur. Primi i pafitur për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto para shpenzimeve të marrjes në sigurim. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e kostos së marrjes në sigurim kundrejt primit të shkruar bruto.

iii) *Dëmet*

Përfitimet e ndodhura për sigurimin e jetës gjatë aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara gjatë vitit financiar bashkë me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Rikuperimet në avancë nga ri-sigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga ri-sigurimi dhe rikuperime të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

iv) *Rezervat për dëmet*

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, duke përfshirë një llogaritje të kostos së dëmeve të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Rezerva për dëmet pezull krijohet rast pas rasti në bazë të shumës së pritshme. Rezervat për dëmet e ndodhura por të pa raportuara krijohen përmes metodës zinxhir.

v) *Dëmet që rrjedhin nga biznesi i sigurimit të jetës.*

Demet e biznesit për sigurimin e jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që dalin gjatë vitit, duke përfshirë shpërblimet e policave të akorduara në pritje të një deklarate bonusi.

2. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

vi) Rezerva të tjera matematikore

Rezerva të tjera është përlogaritur mbi bazë police duke përdorur formula aktuariale standarde të bazuara në rezervën e primeve neto. Vlerësimet mbi mortalitetin janë të njëjta me ato për llogaritjen e tarifave të primeve ndërkohë norma e interesit të përdorur nuk e kalon vlerën prej 2.25% dhe Shoqëria llogarit 85% të normës shtesë të fitimit nëse norma e interesit të fituar rezulton më e lartë sesa interesi teknik i garantuar, duke filluar që nga viti i tretë i sigurimit.

vii) Risigurimi

Kontratat që transferojnë një pjesë kryesore të rrezikut të sigurimit janë kontabilizuar si risigurime. Shumat e rikuperueshme nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit si dhe dëmet përkatëse. Aktivët e risigurimit përfshijnë balancat për t'u arkëtuar nga Shoqëritë e risigurimit për detyrimet nga sigurimet e ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguresit llogariten në të njëjtën mënyrë si janë llogaritur rezervat e dëmeve pezull, ose përbëjnë pjesën e papaguar nga risiguresi të dëmeve të paguara nga Shoqëria që lidhen me policën e risiguruar. Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun për të limituar humbjet e mundshme që rrjedhin nga ekspozimi në rreziqe të konsiderueshme nga sigurimi i jetës. Risigurimi nuk e çliron siguresin fillestar nga detyrimet e tij. Primet e ceduara paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën e ngarkuar gjatë vitit. Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto. Portofoli i produkteve është mbuluar nga një kontratë risigurimi e detyrueshme që mbulon pjesën mbi shumën maksimale të rrezikut për çdo jetë. Çdo përfitim shtesë, ndahet midis shumës së mbajtur dhe tejkalimit në të njëjtin proporcion si shuma e siguruar e jetës. Pjesa e rezervës së risigurimit përcaktohet rast pas rasti në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

viii) Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat "Jeta me Afat", kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit të pafiturat të primeve bruto të shkruara. Rrjedhimisht, kostot e marrjes shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Shoqëria ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standardet e grupit Uniqa. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me supozimet e mëposhtme:

- Normat e zbritjes - Normat e liruara nga rreziku që llogariten dhe merren nga Grupi
- Normat e ndalimit - normat e llogaritura në bazë të përvojës së portofolit
- Shkalla e vdekshmërisë - vdekshmëria nga TM-ja e përshtatur për mbajtësin e policës mesatare për secilin vit të nënshkrimit
- Komisioni - komisionet aktuale të brokerimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e politikave.

ix) Test i mjaftueshmërisë së përgjegjësisë (LAT)

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen testime për t'u siguruar për mjaftueshmërinë e rezervës së dëmeve. Testimet kryesore të kryera janë "Analiza e Raportit të Dëmeve" dhe "Analiza e Zhvillimit të Provizioneve të Dëmeve". Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për produktet kryesore të biznesit (sigurim jete dhe jetë e kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet, por edhe mbi dëme që përfshijnë koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin.

Në kryerjen e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të flukseve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skanton këto flukse monetare të parashikuara sepse shumica e dëmeve priten të ekzekutohen brenda vitit.

Përveç kësaj, Shoqëria kryen çdo vit një analizë rakordimi të rezervave të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj rezervë. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provizion të papërcaktuar të rrezikut nga humbjet që rrjedhin nga Testimi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve. Shoqëria ka përlogaritur LAT për sigurimin afatgjatë të jetës nëpërmjet metodave të jo-jetës dhe për "Jetë me Kursim" me metodat e jetës bazuar në vlerësimet aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, për të vlerësuar mjaftueshmërinë e rezervës për produktin "Jetë me Kursim".

2. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Instrumentet financiare

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe llogari të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera financiare që klasifikohen si të disponueshme për shitje dhe në detyrime financiare jo-derivative.

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative – Njohja dhe çregjistrimi

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato janë krijuar.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale rrjedhës së parave nga aktiv financiar, ose ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar ose në të cilat Shoqëria as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria njihen si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

(ii) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative - Matja

Huamarrjet dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që i atribuohet drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Investimet në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus/minus koston e transaksionit të drejtpërdrejtë. Ato maten më pas me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pasi klasifikohen si të disponueshme për shitje.

Investimet në instrumenta të kapitalit (indekse investimesh), njihen fillimisht dhe më pas me vlerë të drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim /humbje.

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus koston e transaksionit që i atribuohet drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(iii) Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim mund të vendoset midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - ose vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

(iv) Identifikimi dhe zhvlerësimi

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka dëshmi objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuar. Aktivet financiare janë të zhvlerësuar kur dëshmitë objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivit që mund të vlerësohet me besueshmëri.

2. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar mund të përfshijë mos-pagesën ose vonesat e huamarrësit, rristurimin e kredisë ose paradhënies nga shoqëria me kushte që, në rrethana të tjera, Shoqëria nuk do ti kishte konsideruar, tregues se një huamarrës ose emetues do të përballëte me probleme likuiditeti, mbyllja e një tregu aktiv, ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivësh sikurse lëvizjet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësit për Shoqërinë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesën në grup.

Shoqëria merr parasysh dëshmi të zhvlerësimit në të dy nivelet kolektive dhe specifike. Aktivet financiare në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku aktivet me karakteristika të ngjashme kreditore. Aktivet financiare në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmive objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të aktiveve të tilla si mungesa, rristurimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe mos-shlyerjes për më shumë se 90 ditë për një ekspozim të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë të gatshme, depozitat likuide të mbajtura me bankat dhe investime të tjera shumë likuide afatshkurtra me maturim deri në tre muaj nga data e blerjes që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Depozitat me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat janë paraqitur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar në shumën e kryegjësë të mbetur dhe klasifikohen ato depozita me maturim më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë në instrumenta borxhi të cilat Shoqëria sipas politikave dhe përcaktimeve të grupit Uniqa i ka klasifikuar si të disponueshme për shitje, me pagesa fikse ose të përcaktuara, maten me vlerë e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Humbjet e mundshme nga vlerësimi njihen në fitim ose humbje së bashku me interesin e tyre të llogaritur sipas metodës së interesit efektiv.

Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga të siguruarit dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke i zbritur humbjet nga rënia në vlerë.

Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejtë me të. Këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Prona dhe pajisje dhe aktive me të drejtë përdorimi

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronave dhe pajisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe pajisjeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të prona dhe pajisje, i shtohet vlerës së mbartur të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen më këtë element do të shkojnë për Shoqërinë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore të ndërtesave dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

2. Informacion për politikat domethënëse të kontabilitetit (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare sipas ndryshimeve të ligjit dhe udhëzimit të tatimit mbi të ardhurat i cili aplikohet për vitin 2024. Aktivët e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

Ndërtesat	5%
Pajisje zyre	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Mjete motorike	20%

Aktive me të drejtë përdorimi

Shoqëria merr me qira ambientet e saj të selisë qendrore.

Kontratat mund të përfshijnë element që lidhen drejtpërdrejt me qira ose jo. Shoqëria nuk shpërndan koston e elementeve që lidhen me qiranë ose jo por i përfshin të gjitha shpenzimet si pagesa qiraje. Aktivët që janë marrë nëpërmjet qirasë vlerësohen në bazë të vlerës aktuale. Aktivët me të drejtë përdorimi maten bazuar në kosto të përbërë nga shuma e matjes fillestare të detyrimit të qirasë me vlerën e drejtë.

Aktivët me të drejtë përdorimi amortizohen përgjatë kohës më të shkurtër midis jetës së dobishme të aktivit dhe kohëzgjatjes së kontratës. Shoqëria ka përcaktuar afatin e qirasë deri në vitin 2029 duke i amortizuar të drejtat përgjatë një periudhe 5 vjeçare.

Nëse ekziston një mundësi e arsyeshme për të blerë aktivin, e drejta e përdorimit të aktivit amortizohet bazuar në jetën e dobishme.

Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jo-materiale të shoqërisë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara. Licencat e programeve kompjuterike kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim. Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me programe të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë shpenzimet e stafit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programe kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja e saj, janë shpenzuar kur ndodhin.

Aktivët jo-materiale amortizohen duke përdorur metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Detyrimet e qirasë

Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet për qiranë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave fikse.

Mundësitë e shtyrjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të aktualizuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrte hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e të drejtës së përdorimit të aktivit në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Norma rritëse e huamarrjes përcaktohet nga Shoqëria mëmë për të gjitha filialet e saj bazuar në specifikat lokale.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtër të aktiveve dhe të gjitha qiratë për aktivet me vlerë të vogël ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Qiratë afatshkurtër janë qira me kohëzgjatje prej 12 muajsh ose me pak.

2 Informacion për politikat domethënëse të kontabilitetit (vazhdim)

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të veçanta të jenë autorizuar për t'u deklaruar, paraqiten në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension si dhe kontribute për pension vullnetar me kontribute të përcaktuar (jo përfitime). Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin minimal ligjor të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara ndërkohë që punonjësi mbart rrezikun që lidhet me vlerën aktuale neto të planit vullnetar të përfitimeve të pensioneve për të cilin kontribuon edhe Shoqëria. Shoqëria nuk ka detyrime të tjera përveç kontributeve të paguara. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në momentin që ato lindin.

Tatim mbi fitim

Tatim fitimi për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi të ardhurat ose humbjen e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim në tatimin e pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Vlera e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të marrë që reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e tatimeve të miratuara ose të miratuara në mënyrë substanciale në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë kompensuar vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshëm në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë të raportimit dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi përkatës tatimor të realizohet; reduktimet të tilla kthehen kur zgjidhet probabiliteti i fitimeve të tatueshme në të ardhmen.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret në datën e raportimit të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra janë kompensuar vetëm nëse lidhen me të njëjtin autoritet tatimor.

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe në faktorë të tjerë që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrethanave dhe informacioneve në dispozicion në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi kryerjen e vlerat e akteve dhe pasiveve që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare janë diskutuar më poshtë.

Vlerësimi përfundimtar që lind nga dëmet sipas kontratave të sigurimit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga dëmet sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më i rëndësishëm i Shoqërisë. Në këtë vlerësim duhet të përfshihen disa burime të pasigurta të rëndësishme për vlerësimin e detyrimit përfundimtar të Shoqërisë për këto dëme.

Përcaktimi i detyrimeve sipas kontratave afatgjata të sigurimit varet nga vlerësimet e bëra nga Shoqëria. Vlerësimet bëhen duke marrë parasysh pritshmëritë për numrin e vdekjeve për çdo vit që Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut. Shoqëria i bën këto vlerësime në bazuar tek tabelat e personalizuara të vdekshmërisë të përshtatura për të reflektuar eksperiencën e vetë Shoqërisë. Për kontratat të cilat sigurojnë rrezikun e jetëgjatësisë, krijohet një pritshmëri e kujdesshme por jo e tepruar për përmirësimet në lidhje me vdekshmërinë. Burimi kryesor i pasigurisë është që epidemitë (p.sh. SIDA, SARS, COVID, dhe ndryshime të rëndësishme të stilit të jetesës, të tilla si ushqimi, pirja e duhanit, programet ushtrimore, traumat e pasluftës mund të rezultojnë në pritshmëri të vdekshmërisë më negative se në të shkuarën për grup mosha ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar në mënyrë domethënëse ndaj rrezikut të vdekjes. Megjithatë, përmirësimet e vazhdueshme në kujdesin mjekësor dhe kushtet sociale mund të rezultojnë në përmirësime në jetëgjatësisë përtej atyre të marra parasysh në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e detyrimeve që lindin nga kontratat kur Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të jetëgjatësisë.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria kryen analiza për t'u siguruar mbi mjaftueshmërinë e rezervave për kontratat e sigurimit. Testet kryesore lidhen me analizat e raporti të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit mbi linjat kryesore të aktivitetit në mënyrë individuale (sigurimi i jetës për hua dhe sigurimi i kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm për dëmet si edhe për dëmet duke përfshirë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe shpenzime të tjera të trajtimit. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Shoqëria merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i aktualizon këto flukse dalëse sepse pjesa më e madhe e dëmeve pritët të paguhet brenda një viti. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë për supozimet kryesore të përdorura për vlerësimin e detyrimeve nga dëmet paraqitet në shënimin 5.

4. Publikime të reja të kontabilitetit

Shoqëria nuk zbaton më Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") pasi ajo nuk ka zbatuar SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" sipas vendimeve dhe komunikimeve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") për shtyrjen e zbatimit të këtij standardi. Shoqëria pritët që të zbatojë SNRF 17 duke filluar nga data 1 janar 2025. Kjo do të jetë dhe data në të cilën Shoqëria do të zbatojë sërish SNRF-të e do të konsiderohet si tranzicion në SNRF për herë të parë.

5. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë të produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët. Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përllogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

5.1 Objektivat e administrimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe prej pasigurisë rreth shumës së dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo mbart rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në administrimi e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigruer të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen. Kapitali rregullator administrohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperiencia tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

5.2 Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur luhatjet e rezultateve të pritshme.

5.3 Afatet dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, ne disa raste mbulimi kufizohet ne mbulim te pjesshem, te humbjeve si pasojë e aksidenteve. Produktet e tjera pervec Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin e ndryshimit të primin nga ana e Shoqërisë. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si "Sigurim i Jetës për hua" janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat sëbashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

5. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Sigurimi 'jeta e kombinuar'

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave shoqëria nënshkruan mbulimet në grup. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shumën e sigurimit fikse që nuk varen nga shoqëria. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

Jeta me kursim

Përfshin sigurimin e jetës dhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 në 25 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekjeje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila varion nga 2,968 Euro deri në 108,436 Euro (2023: 1,302 Euro deri në 100,040 Euro).

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të administruar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruari kryesor. Nëse risiguruari nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka cënuar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkurara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi me Uniqa RE dhe SIGAL UNIQA Group Austria Sha.

Ekspozimi ndaj ngjarjeve katastrofike

Shoqëria gjykon se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar një ekspozim të rëndësishëm ndaj ngjarjeve katastrofike.

Transaksionet me instrumentet financiare rezultojnë në mbartjen e rrezikut financiar nga ana e Shoqërisë. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruari) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i administron këto rreziqe.

5.4 Interesi teknik

Norma e interesit teknik në intervalin 0-6%, e ndryshme për çdo monedhë, përdoret për të llogaritur primet e sigurimit. Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për çdo kontratë sigurimi për jetën. Në mënyrë shpallëse e rrezikut që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara, norma e interesit në përllogaritjen e rezervave matematike është mbajtur në një nivel jo më lartë se 2.25 %. Në vitin 2024, të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë edhe rezervën matematikore) mbulojnë të ardhurat minimale të garantuara, duke siguruar fitime shtesë mbi interesin teknik. Të ardhurat minimale të garantuara për jetën me kursim jepen me interes të garantuar 4.05%, e cila është pranë normës së përdorur në llogaritje të rezervës matematikore.

Analizat e parametrave aktuarialë të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave për sigurimin e jetës tregojnë që supozimet e bëra janë të besueshme dhe të sakta.

5.5 Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Për të llogaritur rezervën matematikore, shoqëria përdor metodën prospektive neto.

Shoqëria përdor tabelat e mortalitetit të publikuara në Shqipëri dhe të pranuar nga risiguruari. Interesat teknike të përdorura në llogaritjen e primeve ndryshojnë nga 0% deri në 6% në varësi të datës së lëshimit të policës, llojit të kontratës dhe monedhës përkatëse. Rezervat për portofolin Endowment llogariten me një normë interesi jo më të lartë se 2.25%. Rezervat e portofolit të kombinuar dhe për portofolin e jetës së kredit-marrësit, llogariten me një normë interesi 0% për sigurimin me afat vjetor dhe me normën e garantuar të interesit për kontratat me një prim të vetëm për periudha me afat me të gjatë se një vit. Shoqëria përdor metodën zinxhir për të llogaritur IBNR. Kostot e administrimit të dëmit nuk përfshihen në trekëndëshat e përdorur.

5. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Ato llogariten veçmas në masën 2% të rezervës për dëmet pezull. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve bazohet në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës. "Vdekshmëria" është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që shoqëria ka. Të dhënat për rrezikun e "vdekshmërisë" për 2024 janë si më poshtë:

Numri i personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	75,565 njerëz
Mosha e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	18-72 vjeç
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur në 2024	132 raste (këtu janë vendosur pagesat gjatë 2024 edhe për humbje jete të viteve të mëparshme, ndërkohë nga këto 90 kane ndodhur gjatë vitit 2024)
Intervali i numrit të vdekshmërisë të llogaritur në 1,000 njerëz	0.66 deri në 60.56

Intervali i moshës dhe numri i vlerësuar i vdekjeve janë të bazuara në informatat nga Instituti i Statistikave. Kështu që rreziku i "vdekshmërisë" i paraqitur në këtë tabelë është brenda pritshmërisë.

Analiza e ndjeshmërisë

Faktorët kryesor që ndikojnë në fitimin e shoqërisë është niveli i raportit të dëmeve dhe shpenzimeve. Tabela më poshtë paraqet një stimulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

31 dhjetor 2024	Fitimi (Humbja)	Kapitali neto	Fondi i garancisë së detyrueshme
Aktual	134,449	823,422	370,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(24,047)	799,376	370,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(18,796)	804,626	370,000

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrat e pozicionit financiar për qëllime të veçanta. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

	2024	2023
Raporti i dëmeve	18%	22%
Raporti i shpenzimeve	69%	62%
Raporti i kombinuar	87%	84%

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë ndikimin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj ndjeshmërie tregohet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Ndikimi	2024	2023
<u>Raporti i dëmeve</u>			
10% rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(12,096)	(16,062)
10% rënie në raportin e dëmeve	Fitim	12,096	16,062
<u>Raporti i shpenzimit</u>			
10% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(50,481)	(48,419)
10% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	50,481	48,419
<u>Raporti i kombinuar</u>			
10% rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(62,577)	(64,481)
10% rënie në raportin e kombinuar	Fitim	62,577	64,481

5. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

5.6 Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për cdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, i cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij. Përqendrimi i provigjoneve teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	2024			2023		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Lloji i provigjoneve						
RBNS	102,420	-	102,420	109,916	-	109,916
IBNR	32,625	-	32,625	25,889	-	25,889
Shuma te parashikuara per "Surrender to be paid"	51,107	-	51,107	40,654	-	40,654
Provigjoni matematikor	620,535	-	620,535	673,830	-	673,830
Totali	806,689	-	806,689	850,289	-	850,289

Rezerva për risigurimin është zero pasi nuk ka pasur dëme të ceduara në risigurim. Përqendrimi i primeve të shkruara bruto sipas llojit të kontratës është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	2024			2023		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Llojet e kontratave						
Sigurim Jeta për hua	721,011	(7,659)	713,353	640,094	(9,084)	631,010
Sigurim Jeta e kombinuar	43,616	(9,212)	34,404	117,440	(7,883)	109,557
Sigurim Jeta me kursim	56,096	(9)	56,086	68,563	(9)	68,554
Totali	820,723	(16,880)	803,843	826,097	(16,976)	809,121

6. Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe administron rreziqet financiare që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë nëpërmjet analizës së brendshme të rrezikut që përshkruan ekspozimet sipas shkallës dhe madhësisë së rreziqeve. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumente financiare derivateve për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

i. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut mund të përshkruhet si rreziku i ndryshimit në vlerën e drejtë të një instrumenti financiar për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, çmimet e kapitalit ose normat e këmbimit valutor. Shoqëria nuk investon në aksione dhe ka instrumente financiare pothuajse ekskluzivisht të shprehura në Euro. Rreziku i normës së interesit është kryesisht me investime të mbajtura deri në maturim që mbahen me norma fikse.

ii. Rreziku valutor

Shoqëria operon në katër monedha të ndryshme: Lekë, Euro, USD dhe CHF. Rreziku i kurseve të këmbimit në portofolet e investimeve është i administruar duke përdorur parimin e përputhjes midis aktiveve/detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë kontratë për kryerjen e transaksioneve në valutë në të ardhmen ose produkte derivative të këtyre transaksioneve më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

Shoqëria i administron aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë administruar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre. Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksionar.

6. Administrimi i rrezikut të financiar (vazhdim)

Shoqëria vendos objektiva për portofol aktivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brenda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqendrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e administrimit të aktiveve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj dhe si rrjedhim është e ekspozuar ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit.

Shoqëria ka ekspozim minimal ndaj rrezikut të monedhës pasi aktivet financiare të shoqërisë përkojnë kryesisht me të njëjtat valuta si detyrimet kontraktuale të investimit. Si rezultat, rreziku i këmbimit valutor vjen nga aktivet dhe detyrimet të njohura në monedha të tjera.

Aktivët dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	23,058	23,150	1,582	55	47,845
Depozita me afat me bankat	610,748	443,963	90,777	-	1,145,488
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	1,097,539	227,086	-	-	1,324,625
Llogaritë e arkëtueshme	32,963	15,975	-	-	48,938
Aktive të risigurimit	3,985	8,743	9	-	12,737
Totali i aktiveve financiare	1,768,293	718,917	92,368	55	2,579,633
DETYRIMET					
Detyrimet për kontratat e sigurimit	1,053,899	698,670	12,590	-	1,765,159
Llogari të pagueshme për risigurimin	1,189	-	-	-	1,189
Detyrimet e qirasë	-	26,499	-	-	26,499
Llogari e tjera të pagueshme	23,060	11,465	440	-	34,965
Totali i detyrimeve financiare	1,078,148	736,634	13,030	-	1,827,812
Pozicioni neto	690,145	(17,717)	79,338	55	751,821

Aktivët dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	29,139	13,882	4,921	85	48,027
Depozita me afat me bankat	507,886	489,962	88,538	-	1,086,386
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	1,137,902	204,838	-	-	1,342,740
Llogaritë e arkëtueshme	34,885	10,640	-	-	45,525
Aktive të risigurimit	3,684	2,887	8	-	6,579
Totali i aktiveve financiare	1,713,496	722,209	93,467	85	2,529,257
DETYRIMET					
Detyrimet për kontratat e sigurimit	1,001,727	746,029	11,116	-	1,758,872
Llogari të pagueshme për risigurimin	483	3,787	-	-	4,270
Detyrimet e qirasë	-	14,889	-	-	14,889
Llogari e tjera të pagueshme	18,082	1,839	-	-	19,921
Totali i detyrimeve financiare	1,020,292	766,544	11,116	-	1,797,952
Pozicioni neto	693,204	(44,335)	82,351	85	731,305

6. Administrimi i rrezikut të financiar (vazhdim)

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lekë ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Dollari i Shteteve të Bashkuara (USD)	94.26	93,94
Monedha e Bashkimit Europian (EUR)	98.15	103,88
Franga Zvicerane (CHF)	104.27	112.10

iii. Rreziku i normës së interesit

Analiza e ndryshimit ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit është si më poshtë:

	Ndikimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EUR rritet me 10% ndaj Lekë	Fitim	1,772	4,433
EUR ulet me 10% ndaj Lekë	Humbje	(1,772)	(4,433)
USD rritet me 10% ndaj Lekë	Fitim	7,934	8,235
USD ulet me 10% ndaj Lekë	Humbje	(7,934)	(8,235)

Supozimet mbi ndryshimin e kurseve të këmbimit janë vlerësimet më të mira të drejtimit të bazuara në të dhënat e vëzhguara dhe tendencave pas datës së raportimit.

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si rezultat i ndryshimit të normave të interesit në treg si dhe rreziku që maturiteti i interesave në lidhje me aktivet ndryshojnë nga maturiteti i interesave lidhur me detyrimet e përdorura financimin e këtyre aktiveve. Periudha për të cilën norma e interesit të një instrumenti financiar është e fiksuar tregon dhe ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut.

Shoqëria nuk ka detyrime që mbartin interes dhe rreziku i rritjes së kostos së detyrimeve si rezultat i rritjes së normave të interesit nuk është i qenësishëm më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, ndërkohë që normat e interesit të aktiveve janë norma fikse.

31 dhjetor 2024				
	Pa interes	Interes fiks deri ne 1 vit	Interes fiks me shumë se 1 vit	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	47,845	-	-	47,845
Depozita me afat me bankat	-	358,496	767,657	1,126,153
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	-	-	1,324,625	1,324,625
Investime në fonde investimi(kuota) me vlerë të drejtë	10,657	-	-	10,657
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	49,938	-	-	49,938
Aktive të risigurimit	12,737	-	-	12,737
Aktive financiare	120,177	358,496	2,092,282	2,570,955
Detyrimet për kontratat e sigurimit	1,765,159	-	-	1,765,159
Të pagueshme tek risigruuesit	1,189	-	-	1,189
Detyrimet e qirasë	26,499	-	-	26,499
Të tjera të pagueshme	46,781	-	-	46,781
Detyrime financiare	1,839,628	-	-	1,839,628
Hendeku i ndryshimit	(1,719,451)	358,496	2,092,282	731,327

6. Administrimi i rrezikut të financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2023				
	Pa interes	Interes fiks deri ne 1 vit	Interes fiks me shumë se 1 vit	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	48,027	-	-	48,027
Depozita me afat me bankat	-	156,962	929,424	1,086,386
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	-	-	1,342,740	1,342,740
Investime në fonde investimi(kuota) me vlerë të drejtë	10,027	-	-	10,027
Llogaritë e arkëtueshmenga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	45,525	-	-	45,525
Aktive të risigurimit	6,579	-	-	6,579
Aktive financiare	110,158	156,962	2,272,164	2,539,284
Detyrimet për kontratat e sigurimit	1,758,872	-	-	1,758,872
Të pagueshme tek risiguresit	4,270	-	-	4,270
Detyrimet e qirasë	14,889	-	-	14,889
Llogari të tjera të pagueshme	19,921	-	-	19,921
Detyrime financiare	1,797,952	-	-	1,797,952
Hendeku i ndjeshmërisë	(1,687,794)	156,962	2,272,164	741,332

Normat e interesit janë fikse dhe ka aktive financiare ose detyrime të mbartura me vlerën e drejtë. Megjithatë, çdo rritje / ulje me 1% në normën e interesit do të rezultojë në një ndikim neto në vlerën e drejtë prej 24 mijë Lekë (2023: 22 mijë Lekë) para tatimit.

iv. Rreziku kreditor

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare si: depozitat me afat, investimet në letra me vlerë, llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare nuk është i qenësishëm. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8	47,845	48,027
Depozita me afat me bankat	9	1,145,488	1,086,386
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	10	1,324,625	1,342,740
Investime në fonde investimi(kuota) me vlerë të drejtë	12	10,657	10,027
Llogaritë e arkëtueshmenga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	13	48,938	45,525
Aktive të risigurimit		12,737	6,579
Totali		2,590,290	2,539,284

Shoqëria manaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë sistematike duke monitoruar llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi, ajo ka krijuar një rregull të brendshëm ku të gjitha policat e papaguara sipas kushteve të kontratave perkatese anulohen, përveç rasteve ku ka siguri që shumat e arkëtueshme do të mbledhet.

Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme nga ku risiguresit mund të kenë klasifikime BBB- ose më të lartë dhe rreziku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumentave të borxhit dhe depozitave. Shoqëria nuk ka identifikuar të dhëna objektive për zhvlerësim të mjeteve të tjera financiare në datën e raportimit, prandaj drejtimi i konsideron aktivet e tjera financiare si ekuivalentë të mjeteve monetare, depozitat me afat dhe pasuritë e tjera si as të kaluara e as të zhvlerësuar. Cilësia kreditore e aktiveve financiare është paraqitur në shënimet përkatëse në këto pasqyra financiare.

v. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është i pranishëm në biznesin e Shoqërisë pasi aktivet e blera dhe detyrimet e shitura kanë karakteristika likuiditeti specifike. Nëse Shoqërisë do t'i nevojiteshin likuiditete të mëdha brenda një kohe të shkurtër, nuk do të ishte e vështirë për Shoqërinë që ti sugurojë ato nisur nga mënyra e organizimit të investimit në periudha maturimi të diversifikuara. Bazuar në këtë analizë manaxhimi beson se nuk do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare sipas afateve përkatëse.

6. Administrimi i rrezikut të financiar (vazhdim)

Gjithashtu, Shoqëria e monitoron gjëndjen e saj të likuiditetit çdo ditë, për të përmbushur detyrimet në kohën e duhur. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë. Detyrimet për kontratat e sigurimeve janë shpërndarë në bazë të maturitetit të pritur. Normalisht, detyrimet për dëme të raportuara janë të menjëhershme me plotësimin e dosjes përkatëse. Megjithatë, në praktikë, kalendari i shlyerjeve të Shoqërisë mund të ndryshojë nga detyrimi kontraktual apo ligjor i shlyerjes për arsye të ndryshme që nuk pëcaktohen nga Shoqëria por nga rrethanat përkatëse.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	47,845	-	-	-	47,845
Depozita me afat me bankat	63,052	88,033	672,545	321,858	1,145,488
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	20,424	4,828	44,701	1,254,672	1,324,625
Investime ne fonde investimi(kuota) me vlerë të drejtë	-	-	-	-	-
Llogaritë e arketueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	17,128	26,916	4,894	-	48,938
Aktive të risigurimit	602	754	11,381	-	12,737
Totali i aktiveve financiare	149,052	120,531	733,521	1,576,530	2,579,633
DETYRIMET					
Detyrimet për kontratat e sigurimit	5,378	28,767	223,179	1,507,836	1,765,159
Detyrimi i qirasë	504	1,008	4,535	20,452	26,499
Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	37,425	9,356	-	-	46,781
Llogari të pagueshme për risigurimin	1,189	-	-	-	1,189
Totali i detyrimeve financiare	44,495	39,131	227,714	1,528,288	1,839,628
Pozicioni neto i likuiditetit	104,557	81,399	505,807	48,242	740,005

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	48,027	-	-	-	48,027
Depozita me afat me bankat	3,758	38,000	482,336	562,292	1,086,386
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	17,743	3,706	171,970	1,149,321	1,342,740
Investime ne fonde investimi(kuota) me vlerë të drejtë	-	-	-	10,027	10,027
Llogaritë e arketueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	15,920	29,460	145	-	45,525
Aktive të risigurimit	40	1,158	5,381	-	6,579
Totali i aktiveve financiare	85,488	72,324	659,832	1,721,640	2,539,284
DETYRIMET					
Detyrimet për kontratat e sigurimit	21,658	93,034	276,426	1,367,754	1,758,872
Detyrimi i qirasë	542	1,084	6,746	6,517	14,889
Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	15,454	4,467	-	14,889	19,921
Llogari të pagueshme për risigurimin	4,270	-	-	-	4,270
Totali i detyrimeve financiare	41,924	98,585	283,172	1,389,160	1,812,841
Pozicioni neto i likuiditetit	43,564	(26,261)	376,660	332,480	726,443

6. Administrimi i rrezikut të financiar (vazhdim)

Administrimi i kapitalit

Objektivat kryesore të Shoqërisë për administrimin e kapitalit janë:

- të jetë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar;
- të sigurojë mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë në mënyrë që ajo të mund të gjenerojë fitime për aksionerët dhe përfitime për grupet e interesit të tjera.

Në përputhje me ligjin shqiptar Nr. 52/2014 "Për sigurime dhe risigurime", datë 4 korrik 2014, Shoqëria e sigurimit është e detyruar të përmbush kërkesat e nenit 80 dhe 81. Sipas këtyre kërkesave, kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë duhet të jetë së paku shuma e aftësisë paguese të llogaritur (dmth. më e lartë e fondit të garancisë dhe 150% e aftësisë paguese të llogaritur në bazë të të njëjtit ligj). Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Shoqërisë është 127.49% në vitin 2024 (126.02% në vitin 2023).

7. Vlera e drejtë

Matja e vlerës së drejtë përcaktohet duke shfrytëzuar informacionin përkatës të gjeneruar nga transaksionet e tregut që përfshijnë letrat me vlerë të krahasueshme. Ato shpesh bazohen në teknikat e çmimeve të modelit që ulin flukset e ardhshme të parasë përpara vlerës aktuale duke përdorur përhapjen e përshtatshme të kredisë të rregulluar sipas sektorëve në përpjesëtim me kohëzgjatjen e sigurisë, duke marrë gjithashtu parasysh cilësinë e kredisë dhe likuiditetin specifik të emetuesit. Inputet e vëzhguara të përdorura përfshijnë rendimentet referuese. Shoqëria ka aktive financiare të matura me vlerën e drejtë. Politikat kontabël të Shoqërisë dhe shpalosjet kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të dhënies së informacioneve shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacioni i mëtejshëm në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta shpaloset si vijon:

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe depozitat me afat me bankat - të cilat përfshijnë mjetet në bankë dhe depozitat me afat, përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe zërat në rrjedhën e mbledhjes. Meqenëse depozitat janë afatshkurtra dhe me norma lundruese, vlera e tyre e drejtë konsiderohet si e përafërt me vlerën e tyre të mbartur.

Investimit në letrat me vlerë - Obligacionet janë aktive që mbartin interes deri në maturim. Për shkak se nuk ekziston një treg aktiv për këto letra me vlerë, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të skontuara bazuar në një kurbë aktuale të të ardhurave të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Teknikat e vlerësimit siç janë modelet e skontuara të flukseve të mjeteve monetare ose modelet e bazuar në transaksionet e fundit të krahut të punës ose shqyrtimi i të dhënave financiare të të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimeve të tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive ose detyrimet njëjta, (ii) matjet e nivelit të dy janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale, dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e observueshme të tregut (domethënë matja kërkon hyrje të konsiderueshme të pakontrollueshme). Vlera e drejtë e aktiveve financiare të Shoqërisë, niveli i matjes së vlerës së drejtë dhe kategoria e matjes janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e mbartur
Aktive financiare që nuk maten me vlerë të drejtë				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	47,845	47,845	48,027	48,027
Depozita me afat me bankat	1,145,488	1,145,488	1,086,386	1,086,386

8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse në bankë në EUR	23,058	29,139
Llogari rrjedhëse në bankë në ALL	23,150	13,882
Llogari rrjedhëse në bankë në USD	1,582	4,921
Llogari rrjedhëse në bankë në CHF	55	85
Totali	47,845	48,027

Të gjitha mjetet monetare në arkë dhe në bankë, plotësojnë përkufizimin e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalente. Mjetet monetare të Shoqërisë cilësohen si jo në vonesë dhe as të zhvlerësuar pasi nuk ka indikatorë zhvlerësimi ose reduktim të ndjeshëm në klasifikimin kreditor të bankave me të cilat ato mbahen.

Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e bankave sipas agjensive të ndryshme. Bankat që nuk kanë klasifikim nuk konsiderohen si me rrezik likuiditeti nga Banka e Shqipërisë.

	Agjensia	Vlerësimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Banka Kombëtare Tregtare	JCR Eurasia	BB	8,476	4,854
Raiffeisen Bank	S&P	AA-	12,742	22,181
Banka Amerikane e Investimeve	Nuk ka	-	4,820	5,431
Intesa SanPaolo Bank	S&P	Baa1	6,645	2,820
Banka OTP Albania	S&P	Baa1	9,471	4,929
ProCredit Bank	Fitch	BBB	874	1,356
Union Bank	Nuk ka	-	1,396	1,807
Credins Bank	Nuk ka	-	1,887	1,638
Tirana Bank	Nuk ka	-	1,345	896
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Nuk ka	-	189	2,115
Totali			47,845	48,027

9. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozita për fondin e garancisë	376,348	371,529
Depozita me afat	749,805	694,684
	1,126,153	1,066,213
Interesi përlllogaritur	19,335	20,173
TOTALI	1,145,488	1,086,386

Në përputhje me nenin 81 të Ligjit Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit", lidhur me fondin e garancisë, Shoqëria mban të bllokuar për fondin e garancisë jo më pak se një të tretën e kufirit minimal të aftësisë paguese të percaktuar ose 370,000 mijë Lekë, cilado që është më e lartë. Fondi i garancisë duhet mbajtur në bono thesari dhe/ose depozita me afat jo më pak se një vit, specifikisht të bllokuara për fond garancie.

Cilëesia kreditore e depozitave me afat me bankat

Një ndarje e mjeteve financiare sipas monedhës detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	31 dhjetor 2024	Norma interesit	31 dhjetor 2023	Norma interesit
		%		%
Në EUR	437,749	1.3-2.50	483,561	1.40-2.20
Në USD	88,604	1.0-3.20	87,552	0.60-3.20
Në Lekë	599,800	1.8-4.10	495,100	1.1-3.40
Interes i përlllogaritur	19,335		20,173	
Totali	1,145,488		1,086,386	

Të gjitha depozitat, duke përfshirë edhe depozitat e bllokuara për fondin e garancisë, sipas kushteve të përgjithshme kontraktuale kanë maturitet 12 mujor, 24 mujor dhe 60 mujor.

9. Depozita me afat me bankat (vazhdim)

Depozitat me afat të Shoqërisë cilësohen si jo në vonuara dhe as të zhvlerësuar pasi nuk ka asnjë tregues për rënie të cilësisë kreditore të bankave me të cilat shoqëria punon. Klasifikimi kreditor i bankave me të cilat shoqëria punon është si në vijim:

	Agjensia	Vlerësimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Banka Amerikane e Investimeve	Nuk ka	-	200,193	251,668
Banka Kombëtare Tregtare	JCR Eurasia	BB	539,726	413,853
Raiffeisen Bank	S&P	AA-	112,109	106,697
Tirana Bank	Nuk ka	-	32,228	33,489
Procredit Bank	Fitch	BBB	60,945	31,000
Union Bank	Nuk ka	-	83,353	76,906
Intesa Sanpaolo Bank	S&P	Baa1	45,000	40,000
Banka OTP Albania	S&P	Baa1	52,600	112,600
Totali			1,126,154	1,066,213

10. Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Vlera nominale	1,248,690	1,333,955
Interes i përlogaritur	28,659	26,790
Rivlerësimi me vlerën e drejtë	47,276	(18,005)
Vlera neto	1,324,625	1,342,740

Investimet në letra me vlerë të disponueshme për shitje më 31 dhjetor 2024 janë obligacione të Qeverisë së Shqipërisë kryesisht në Lekë me maturitet prej 4 deri në 10 vjet dhe normë interesi nga 3.3 – 8.0% (2023: nga 3.3 – 8.9%). Këto investime nuk janë në vonesë dhe nuk janë të zhvlerësuar. Vlerësimi i Shqipërisë sipas S&P është rritur nga B+ në BB- me një perspektivë të qëndrueshme.

11. Investime në filiale me kosto

Që prej datës 15 dhjetor 2010, Shoqëria zotëron 51% të aksioneve të Shoqërisë së Administrimit të Fondeve Sigal Life Uniqa Group Austria Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A. Vlera e investimit më 31 dhjetor 2024 është 11,232 mijë Lekë (2023: 11,232 mijë Lekë). Kapitali neto i filialit më 31 dhjetor 2024 ishte 144,229 mijë Lekë. Filiali administron disa fonde vullnetare të pensioneve me kontribut të përcaktuar dhe një fond investimi kolektiv.

Shoqëria mëmë, Sigal Uniqa Group Austria SH.A. përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me kërkesat ligjore për shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve për Grupin Sigal Uniqa Group Austria SH.A. në të cilat përfshihen si Shoqëria ashtu edhe Filiali. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë janë publike dhe mund të lexohen në faqen e saj të internetit. Këto pasqyra financiare individuale duhet të lexohen së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë. Për këtë arsye, filiali nuk është konsoliduar në këto pasqyra financiare individuale.

12. Investime ne fonde investimi (kuota) me vlerë të drejtë

Që prej vitit 2019, shoqëria ka investuar në indeksin "WVP TOP INVEST" të fondit të investimit të administruar nga WVP Fund Management Tirana SH.A i cili përqëndrohet në investime në kompani të mirënjohura dhe aksione që paguajnë dividendë duke blerë 9,205.6619 kuota me çmim 1,157.6242 Lekë për kuotë me vlerë totale prej 10,000 mijë Lekë.

Me datë 31 dhjetor 2024, kuotat e blera të vlerësuara me çmimin e tyre në këtë datë paraqiten si më poshtë në lekë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Çmimi i kuotës	1,157.6242	1,089.1717
Numri i kuotave të blera	9,205.6619	9,205.6619
Vlera e investimit në Lekë	10,656,697	10,026,546

13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga policë-mbajtësit	47,196	38,291
Detyrim nga shoqëria mëmë	-	2,254
Të tjera të arkëtueshme	1,742	4,980
Totali	48,938	45,525

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit në vonesë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 por jo të çvlerësuara janë në vonesë për më pak se një vit.

Shoqëria nuk ka njohur provigjion për këto llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit bazuar në vlerësimin e tyre individual.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Në vonesë por jo të çvlerësuara		
<i>0 - 3 muaj</i>		
- Sigurimi i Jetës për hua	40,860	33,192
- Sigurimi i Jetës me Kursim	5,193	4,948
- Sigurimi i Kombinuar	24	6
	46,077	38,146
<i>3 - 12 muaj</i>		
- Sigurimi i Jetës për hua	702	-
- Sigurimi i Jetës me Kursim	416	145
	1,118	145
Totali	47,195	38,291

14. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim

Për produktet e sigurimit te jetës me ose pa elemente kursimi, kosto të shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë komisionet si përqindje e primit të shkruar si më poshtë.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Jetë e debitorit për kontratat me prime të rinovueshëm vit pas viti	1,177	8,459
Jetë e debitorit për kontratat me prim të vetëm	987	1,417
Jetë me kursim	17,497	25,646
Totali	19,661	35,522

	2024	2023
Më 1 janar	35,522	38,275
Kosto të marrjes në sigurim gjatë vitit	320,701	306,343
Shpenzimi i marrjes në sigurim për vitin	(336,562)	(309,096)
Totali	19,661	35,522

15. Prona dhe pajisje dhe aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

	Ndërtesa	Pajisje zyre	Mjete Motorike	Pajisje kompjuterike	Aktive me të drejtë përdorimi	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2023	15,941	961	9,056	6,289	41,419	73,666
Shtesa	-	75	-	183	-	258
Pakësim		(198)	-	(426)	-	(624)
Më 31 dhjetor 2023	15,941	838	9,056	6,046	41,419	73,300
Shtesa	-	557	168	-	-	725
Pakësim	-	-	-	-	-	-
Rinovime	-	-	-	-	16,565	16,565
Më 31 dhjetor 2024	15,941	1,396	9,223	6,046	57,984	90,590
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2023	7,023	836	6,390	4,712	21,268	40,229
Shpenzimi i vitit	446	150	533	266	6,718	8,113
Pakësim	-	(176)	-	(389)	-	(565)
Më 31 dhjetor 2023	7,469	810	6,923	4,589	27,986	47,777
Shpenzimi i vitit	424	119.67	220	255	5,971	6,990
Pakësim	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	7,893	930	7,143	4,844	33,957	54,767
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2023	8,472	28	2,133	1,457	13,433	25,523
Më 31 dhjetor 2024	8,048	466	2,081	1,202	24,027	35,823

Pronat dhe paisjet e shoqërisë nuk janë të vendosura si kolateral për palë të treta më 31 dhjetor 2024 apo 2023. E drejta e përdorimit është e lidhur me qiranë e zyrave qendrore të Shoqërisë. Shoqëria merr me qira zyrën qendrore nga shoqëria mëmë. Afati i qirasë parashikohet në varësi të përdorimit të synuar të zyrës. Në kontratë nuk ka shuma/pagesa variabël dhe opsionet e zgjatjes së kontratës janë marrë parasysh deri në fund të vitit 2029.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet e qirasë - afatshkurtra	20,452	8,372
Detyrimet e qirasë - afatgjata	6,047	6,517
Detyrimet e qirasë	26,499	14,889

Shpenzimi i interesit për detyrimin e qirasë gjatë vitit ishte 1,071 mijë Lekë (2023: 610 mijë Lekë).

Totali i pagesave të qirasë gjatë vitit ishte 7,858 mijë Lekë (2023: 6,517 mijë Lekë).

16. Aktive afatgjata jo-materiale

	Programme kompjuterike
Kosto	
Më 1 Janar 2023	10,717
Shtesa	1,907
Më 31 dhjetor 2023	12,624
Shtesa	683
Pakësime	-
Më 31 dhjetor 2024	13,307
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2023	2,873
Shpenzimi i vitit	1,655
Më 31 dhjetor 2023	4,528
Shpenzimi i vitit	1,919
Më 31 dhjetor 2024	6,447
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2023	8,096
Më 31 dhjetor 2024	6,860

Shoqëria prej vitit 2018 përdor programin kompjuterik Osis Life për produktin e sigurimit të jetës me kursim. Ky program është zhvilluar prej vitit 2014 dhe është njohur si aktiv ne proces deri në vitin 2018. Drejtimi ka kryer testim për zhvlerësimin dhe ne vitin 2018 njohu një zhvlerësim prej 50% të kostos së programit. Gjatë vitit 2020 është kontraktuar zhvillues i ri për sistemin e shitjes LIS, i cili ka hyrë në përdorim në vitin 2021. Gjatë vitit 2022 janë bërë investime në programin e shitjes LIS dhe programin F5 në përshtatje me kërkesat ligjore për fiskalizim me shoqëritë përkatëse zhvilluese. Gjatë vitit 2023 janë bërë investime në programin e shitjes LIS. Gjatë vitit 2024 janë bërë investime në programin e shitjes LIS dhe programin F5 në përshtatje me kërkesat ligjore për fiskalizim me shoqëritë përkatëse zhvilluese

17. Rezervat teknike dhe matematike, rezervat për primin e pafituar, aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva për dëmet pezull	102,420	109,916
Rezerva për e dëmeve të pa-raportuara ("IBNR")	32,625	25,889
Kontrata të tërhequra "surrender"	51,107	40,654
Provizion për rezervat teknike (a)	186,152	176,459
Rezerva matematikore – Jeta me kursim	588,235	636,848
Rezerva e primit të pafituar – Jeta me kursim	32,299	36,982
Rezerva të tjera matematikore (b)	620,535	673,830
Rezerva për sigurimin me afat	945,494	869,151
Rezerva për sigurimin personal	12,978	39,432
Rezerva për primin e pafituar (c)	958,472	908,583
Rezerva matematikore dhe për primin e pafituar (b) + (c)	1,579,007	1,582,413

17. Rezervat teknike dhe matematike, rezervat për primin e pafituar, aktive të risigurimit (vazhdim)

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva për kontratat e sigurimit, bruto (a) +[(b) + (c)]	1,765,159	1,758,872
<i>Të rikuperueshme nga risiguresit</i>		
Rezerva për sigurimin me afat	(5,065)	(4,110)
Rezerva për sigurimin personal të jetës	(1,510)	(2,469)
Pjesa e risiguresit në detyrimet e sigurimit	(6,575)	(6,579)
Rezerva për kontratat e sigurimit, neto	1,758,584	1,752,293

Rezerva e primit të pafituar për produktin “Jeta me kursim” përfshihet në rezervën matematikore. Lëvizjet në dispozitat e kontratës së sigurimit janë përmbledhur më poshtë:

Rezerva për kontratat e sigurimit	2024	2023
Rezerva për dëmet pezull dhe dëmet e pa-raportuara më 1 janar	176,459	160,615
Rregullimi i shpenzimeve për humbjet e ndodhura	179,203	160,623
Pagesa të kryera	(169,509)	(144,779)
Më 31 dhjetor	186,154	176,459

Rezerva të tjera matematikore	2024	2023
Më 1 janar	1,582,413	1,611,913
Ndryshimi në rezervat e tjera matematikore në vijim të vlerësimeve dhe përditësimit të ndryshoreve të përdorura	(3,407)	(29,500)
Rezervat të tjera matematikore më 31 dhjetor	1,579,006	1,582,413

18. Llogari të pagueshme për risigurimin

Llogari të pagueshme për risigurimin janë të drejta që lindin nga kontratat e risigurimit me Uniqa RE, Zurich Re dhe shoqërinë mëmë për mbulimin e rrezikut nga siguri i “jetës për hua/e debitorit” dhe kontratat e sigurimit për “aksidentet personale”.

19. Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe detyrime të tjera

Llogari të pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet ndaj bashkë-siguruesve dhe klientëve	5,225	3,945
Detyrime në lidhje me sigurimet dhe të tjera	28,667	15,086
Detyrime të ndryshme	1,072	890
Detyrime financiare	34,964	19,921
Tatim në burim	9,921	11
Tatim mbi te ardhura personale	810	1,011
TVSH e pagueshme	487	718
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	599	676
Totali	46,781	22,337

20. Kapitali aksionar

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 370,000 mijë Lekë (2023: 370,000 mijë Lekë). Kapitali aksionar i autorizuar është i përbërë nga 370,000 (2022: 370,000) aksione plotësisht të paguara me një vlerë nominale prej 1,000 mijë Lekë secili (2023: 1,000 mijë Lekë). Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 struktura e aksionarëve është si më poshtë:

	Në %	31 dhjetor 2024 Në '000 Lekë	31 dhjetor 2023 Në '000 Lekë
Sigal Uniqa Group Austria SH.A.	99,9997%	369,999	369,999
UNIQA Österreich Versicherungen	0.0003%	1	1
Totali	100%	370,000	370,000

Gjatë vitit 2024, Shoqëria shpërndau dividend në vlerën 174,879 mijë Lekë, (2023: 85,727 mijë Lekë) ose 473 lekë për aksion (2023: 232 lekë për aksion).

Rezerva e rrezikut të sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit është krijuar në bazë të nenit 93 të Ligjit “Për sigurimet dhe risigurimet” në masën 1/3 të fitimit të vitit paraardhës nëse ai nuk është përdorur për të mbuluar humbjet e trashëguara nga vitet e mëparshme. Kjo rezervë duhet të llogaritet minimalisht 30% e shumës mesatare të primeve të shkruara neto gjatë dy viteve të fundit. Me ndryshimin e ligjit (52/2014), kjo rezervë nuk llogaritet më.

21. Primet e shkruara bruto

Primet e shkruara bruto sipas llojit të produktit janë detajuar më poshtë:

	2024	2023
Sigurim “Jeta për hua (e debitorit)”	721,011	640,094
Sigurim “Jeta me kursim”	56,096	68,563
Sigurim “Jeta e kombinuar”	43,616	117,440
Totali	820,723	826,097

22. Të ardhurat nga interesi

	2024	2023
Të ardhurat nga interesi për depozitat me afat	22,551	19,007
Të ardhurat nga interesi për investimet në letra me vlerë të disponueshme për shitje	73,551	66,966
Totali	96,102	85,973

23. Shpenzimet e marrjes në sigurim

	2024	2023
Komisione ndërmjetësit të agentëve dhe ndërmjetësve	319,787	305,768
Ndryshimi në koston e shtyrë të marrjes në sigurim	15,861	2,753
Analiza mjekësore	914	575
Totali	336,562	309,096

24. Shpenzime administrative

	2024	2023
Shpenzime personeli	75,298	66,766
Shërbime të jashtme	14,237	52,091
Shpenzime marketingu dhe promocioni	19,650	25,416
Shpenzime amortizimi	8,909	9,768
Shpenzime udhëtimi dhe transporti	713	963
Posta dhe telekomunikacioni	408	362
Totali	119,215	156,246

Tarifa e firmës së auditimit për vitin 2024 ishte 1,358 mijë lekë dhe përfshihet në shërbime të jashtme. Firma e auditimit të jashtëm nuk ka kryer shërbime jo-auditimi për Shoqërinë gjatë vitit.

25. Shpenzime të tjera operative

	2024	2023
		9,953
	10,585	
Shpenzimet për kontributin ndaj AMF		
Humbje nga mosarketimi	-	-
Taksa vendore	2,152	2,901
Gjoha dhe penalitete	300	-
Shpenzime kancelari, administrative të tjera	62,750	5,868
Shpenzime të pazbritshme	-	67
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aseteve	-	59
Totali	75,788	18,848

26. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi në Shqipëri ka një normë 15% të fitimit të tatueshëm.

Shpenzimi i tatim fitimit përbëhet si më poshtë:

	2024	2023
Shpenzime për tatimin mbi fitimin e vitit	25,737	33,042
Shpenzime tatimi i shtyrë	-	-
Tatim fitimi	25,737	33,042

Llogaritjet e tatim fitimit në bazë të fitimit para tatimit me normat e zbatueshme të tatimeve janë si më poshtë:

	2024	2023
Fitimi para tatimit	160,186	207,922
Shpenzimi i tatim fitimit me normën 15%	24,028	31,188
Shpenzime të pazbritshme	11,394	12,362
<i>Penalitete dhe shpenzime të tjera të pazbritshme</i>	300	-
<i>Shpenzime borxh i keq</i>	-	67
<i>Standardi i qirasë (e drejta e përdorimit dhe detyrimi i qirasë)</i>	1,016	824
<i>Kontratë sponsorizimi (me FSHF)</i>	10,078	11,412
<i>Vlera kontabel nxjerrje jashte përdorimit AAGJ materiale</i>	-	59
Fitimi i tatueshëm	171,580	220,284
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	25,737	33,043

Lëvizjet e tatim fitimit janë si më poshtë:

	2024	2023
Gjendja në fillim	(16,446)	(1,180)
Shpenzim tatim fitimi	(25,737)	(33,042)
Parapagim i tatim fitimit	45,866	17,776
Tatim fitimi (për t'u paguar)/i parapaguar	3,683	(16,446)

Parapagimet për tatim fitimin për vitin aktual janë kompensuar kundrejt detyrimit për tatimin fitimin e vitit aktual paraqitur në zërin e "Tatimit fitimi i parapaguar" në pasqyrat financiare individuale.

26. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimet e shtyra të analizuara sipas diferencave të përkoshme paraqiten më poshtë:

	1 janar 2023	Fitim/ humbje	Të ardhura të tjera gjithë- përfshirëse	31 dhjetor 2023	Fitim/ humbje	Të ardhura të tjera gjithë- përfshirëse	31 dhjetor 2024
Aktive me të drejtë përdorimi	(3,022)	1,008	-	(2,014)	(1,589)	-	(3,603)
Investime në letra me vlerë të disponueshme për shitje	20,226	-	(17,529)	2,697	-	(9,792)	(7,095)
Detyrimi i qirasë	3,117	(884)	-	2,233	1,741	-	3,974
Aktivi/(detyrimi) tatimor i shtyrë neto	20,321	124	(17,529)	2,915	152	(9,792)	6,724
Aktivi tatimor i shtyrë i njohur						(7,095)	(7,095)
Aktiv tatimor i shtyrë që nuk është njohur	20,226	-	(17,529)	2,697	-	(2,697)	
Aktivi tatimor i panjohur	95	124	-	219	152		370
Aktivi/(detyrimi) tatimor i shtyrë neto	20,226	-	(17,529)	2,697	-	(9,792)	(7,095)

27. Detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet**i. Çështjet ligjore**

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria është e përfshirë në padi të ndryshme dhe veprime juridike. Sipas mendimit të drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt të pafavorshëm material ndaj pozicionit financiar të Shoqërisë ose ndryshimet në aktivet neto. Rastet juridike janë të zakonshme kur paraqitësit e kërkesave nuk pajtohen me vlerësimin e kërkesës së tyre prej Shoqërisë. Drejtimi i vlerëson kërkesat duke përdorur ekspertizën e jashtme dhe të brendshme juridike. Drejtimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme, por pranon që rezultati përfundimtar mund të jetë më i lartë ose më i ulët sesa shuma e parashikuar.

Më 31 dhjetor 2024, ka pasur 7 padi të pazgjidhura ku në kërkesat totale të klientëve vlerësohen të jenë 66,084 mijë Lekë (2023: 6 padi të pazgjidhura ku kërkesat totale të klientëve ishin 59,865 mijë Lekë). Vlerësimet e Shoqërisë dhe dispozitat përkatëse bazohen në pritshmëritë e juristit të saj, vendimet e gjykatave të shkallës së parë, përvojat e kaluara, dhe analizat historike për pretendimet në proceset gjyqësore. Në bazë të tyre, Shoqëria ka njohur rezervën në të njëjtën sasi që do të ishte të pagueshme në bazë të kërkesës.

28. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë influencë domethënëse ndaj palës tjetër për të marrë vendime financiare ose operuese, ose palët janë nën kontrollin e përbashkët me Shoqërinë.

Shoqëria ka ndërmarrë një numër transaksionesh me palët e lidhura gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm. Volumi i këtyre transaksioneve dhe gjëndjet pezull në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pasqyra e pozicionit financiar			
Të pagueshme ndaj Sigal Uniqa Group Austria Sh.a	Mëmë	5,391	-
Të pagueshme nga Sigal Uniqa Group Austria Sh.a	Mëmë	-	2,254
Të pagueshme ndaj UNIQA Insurance Group AG	Nën kontroll	2,563	-
Të pagueshme nga UNIQA Insurance Group AG	Nën kontroll	-	-
Të pagueshme ndaj UNIQA RE	Nën kontroll	-	3,787
Të pagueshme nga UNIQA RE	Nën kontroll	6,162	-
Pasqyra e ndryshimeve në kapital			
Dividendi i paguar ndaj Sigal Uniqa Group Austria SH.A	Mëmë	174,879	85,727
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave			
Shpenzime për stafin menaxherial kryesor	Menaxhimi kryesor	36,019	31,069
Paga e stafit drejtues	Menaxhimi kryesor	12,080	10,149
Shpërblime të stafit drejtues	Menaxhimi kryesor	22,936	20,349
Kontributet e stafit drejtues	Menaxhimi kryesor	1,003	526
Të ardhura nga qiraja prej Sigal Uniqa Group Austria SH.A.	Mëmë	240	240
Të ardhura kontrata bashkesigurimi Sigal Uniqa Group Austria sh.a	Mëmë	458	-
Kosto menaxhimi	Nën kontroll	9,037	7,670
Qira vjetore për Sigal Uniqa Group Austria SH.A.	Mëmë	6,047	6,517
Prime risigurimi nga Sigal Uniqa Group Austria SH.A.	Mëmë	1,655	2,939
Pagesa komisioni nga kontrata e risigurimit me Uniqa RE	Nën kontroll	4,890	-
Prime risigurimi nga Uniqa RE	Nën kontroll	10,253	10,617

SKEDULET SUPLEMENTARE (të pa-audituar)

Aftësia paguese

Shuma e kërkuar e fondit të garancisë në përputhje me ligjin nr. 52/2014 “Mbi veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, duhet të jetë më e madhja ndërmjet 1/3 të nivelit të aftësisë paguese dhe 370,000 mijë Lekë (Fondi i garancisë). Niveli aktual i fondit të garancisë më 31 dhjetor 2024, është brenda nivelit të kërkuar.

Aftësia paguese më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

	Shuma në '000 Lekë
1 Kapitali aksionar i paguar (derdhur)	370,000
2 Rezervat që nuk u korrespondojnë përgjegjësive të marrjes në sigurim: Rezerva ligjore Rezerva të lira.	
3 Rezerva e sigurisë, që nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi	272,811
4 Fitime të mbartura: Të mbartura nga vitet e mëparshme, Fitime të pashpërndara për vitin ushtrimor.	140,404 5,955 134,449
5 Me kërkesën e shoqërisë së sigurimit dhe paraqitjen prej saj të provave të mjaftueshme, rezervat (plus vlerat) e fshehura që rrjedhin nga nënvlerësimi i aktiveve, për aq sa këto rezerva (plus vlera) të fshehura nuk kanë natyrë jo të zakonshme	-
6 Vlera e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara sipas bilancit:	6,860
7 Rezerva që rezultojnë nga rivlerësimi i aktiveve:	40,207
Totali (1 + 2 + 3 + 4 + 5 – 6 + 7)	816,563
Niveli aktual i aftësisë paguese	816,563
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese	220,597
Niveli i kërkuar i fondit të garancisë	370,000

Niveli aktual i Fondit të garancisë prej 376,348 mijë Lekë më 31 dhjetor 2024 është brenda niveleve të kërkuara (2023: 371,529 mijë Lekë).

Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike

Në përputhje me Nenin 97 të ligjit 52/2014 për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë jo më shumë se normat e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve për të mbuluar rezervën teknike dhe matematike:

			31 dhjetor 2024
Provigjione teknike dhe matematike bruto			1,765,159
	Kufiri i investimeve në raport me provigjonet	Kufiri i investimit në vlerë	Aktivët në mbulim të provigjoneve bruto
Paraja në arkë dhe bankë (depozita më pak se 3 muaj)	3%	52,955	47,845
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera (maturitet më të vogël se 3 muaj)	20%	191,694	47,602
Letra me vlerë të tregëtuar në tregje të parregulluara	10%	176,516	-
Depozita me afat (pa përfshirë fondin e garancisë)	100%	1,765,159	756,153
Investime në letra me vlerë (pa përfshirë fondin e garancisë)	No limit		1,297,607
Investime të tjera financiare	40%	703,549	10,657
Aktive të risigurimit (klasifikuar mbi BBB-)	No limit		12,737
Tokat dhe ndërtesa	30%	529,548	8,048
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara përjashtuar tokat dhe ndërtesat	5%	88,258	3,748
Interes i llogaritur dhe shpenzime të parapaguara	5%	88,258	46,352
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	15%	264,774	19,661
Totali			2,250,412
Niveli i mbulimit			127.49%